



Zerave per nje largim te mundshem te trainerit Nevil Dede i ka ardhur fundi. Klubi bardhelbu ka publikuar nje deklarate per shtyp per te sqaruar te gjithet. "Klubi i Futbollit Tirana, permes kesaj deklarate per shtyp, sqaron opinionin publik dhe ate sportiv se, mbeshtet dhe do te vazhdoje te mbeshtese projektin e perbashket te filluar me z. Nevil Dede. Klubi i Futbollit Tirana ka nenshkruar nje Kontrate pune me Z. Dede ne muajin Shkurt 2013, te rinovuar me pas ne Maj te po ketij viti dhe shprehim po te njejtin vullnet per respekimin dhe vazhdimesine e saj. Te gjitha lajmet e publikuara ne median e shkruar dhe ate vizive jane spekulime te pabaza, te paverteta; jane montatura mediatike dashakeqese ne dem te interesave dhe pozicionit te klubit tone. Klubi i Futbollit Tirana do te vazhdoje bashkepunimin me trajnerin e saj duke, besuar fuqimisht ne projektin e filluar tashme, ku Z. Dede eshte dhe do te jete arkitekti i Tiranës se ardhshme. Tregues i qarte i ketij vullneti eshte vijueshmeria normale e procesit stervitor nen drejimin e Trajnerit, Z. Dede. Tregues i qarte i ketij vullneti eshte qendrimi i mbajtur ne menyre konstante nga drejtuesit dhe partneret e Klubit, ku ne menyre kategorike jane mohuar spekulime te kesisoj natyre. Klubi i Futbollit Tirana eshte duke u pergatitur per ndeshjen e radhes te Kampionatit Kombetar te Kategorise Superiore, ku fokusi qendron ne arritjen e nje fitore kunder F.K. Partizanit. i gjithet stafi teknik dhe drejtues eshte i perqendruar drejt ketij objektivi lehtesisht te arritshem. Harmonia dhe kohezioni brenda grupit te lojtareve dhe stafit teknik eshte i palekundshem dhe nuk mund te cenohet nga hipoteza dhe trillime mediatike. Si perfundim, ftojme te gjithet sportdashesit e Tiranës te perkrahin te shumte ne numert skuadren tone perpara dhe gjate derbit, duke besuar ne nje fitore historike javen e ardhshme".